

Informacion mbi ndarjen dhe shkurorëzimin:

Në martesë

Në bashkëjetesë të regjistruar

Në bashkëjetesë

Jam e martuar/jetoj në një bashkëjetesë të regjistruar dhe dua të ndahem. Si duhet të veproj?

Ju mund të filloni një [procedurë për ndarjen ligjore](#) në [gjykatën përkatëse të qarkut](#) në vendbanimin tuaj. Procedurën mund ta filloni vetë ose përmes një përfaqësimi ligjor. Nëse është e mundur, merrni me vete dokumentet e mëposhtme në konsultën fillestare të këshillimi ligjor ose në konsultën në zyrën e gjykatës:

- Dokumentet për situatën tuaj financiare (dy deklaratimet e fundit të tatimeve dhe faturat tatimore, borderonë e të ardhurave për 3 deri në 6 muajt e fundit, kuponat për shpenzime të përsëritura, lëvizjet e llogarisë bankare për periudhën 3 deri në 6 muajt)
- Shënime/dokumente për ecurinë e martesës (të dhëna të rëndësishme dhe ngjarje, si p.sh. ushtrim të dhunës nga bashkëshortja/bashkëshorti, certifikata mjekësore, dokumente rreth procedurës penale, masave të mbrojtjes ndaj dhunës).

Sa kushton një procedurë e ndarjes ligjore dhe kush paguan për përfaqësimin ligjor?

Nëse jetoni në rrethana të vështira financiare, ju ose përfaqësimi juaj ligjor mund të paraqisni një [kërkesë](#) për një proces gjyqësor dhe përfaqësim ligjor falas. Nëse kërkesa miratohet, shpenzimet gjyqësore dhe të përfaqësimit ligjor do të

mbulohen përkohësisht nga shteti. Nëse më vonë e gjeni veten në rrethana të favorshme financiare, gjykata mund të kërkojë nga ju rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore dhe të përfaqësimit brenda 10 viteve. Nëse e tërhiqni kërkesën tuaj për ndarje ligjore, mund t'ju duhet të [mbuloni vetë shpenzimet](#) ligjore (të mbrojtjes) dhe gjyqësore të bëra deri në këtë pikë. Nëse jeni në gjendje t'i mbuloni vetë shpenzimet e përfaqësimit, mund të mësoni për shpenzimet e procedurës ligjore të ndarjes nga një qendër këshillimi ose përfaqësimi ligjor.

Çfarë mund të rregulloj me procedurën e ndarjes ligjore?

Sipas kërkesës, gjykata ndër të tjera do të rregullojë pikat e mëposhtme:

- Përcaktimin e banesës
- Përcaktimin e përgjegjësisë të kujdesit për fëmijët
- Shumën e kontributit për jetesë
- Ndarjen e pasurisë

Kam frikë se situata do të marrë përmasa edhe më të rrezikshme, kur partneri im të marrë vesh për ndarjen!

Nëse partneri juaj ushtron dhunë ndaj jush ose ndaj fëmijëve ose nëse ju kërcënon me dhunë, në një situatë akute, [policia](#) mund të marrë masa mbrojtëse ([Ligji për Mbrojtje nga Dhuna](#)). Ajo ka të

drejtë të zbatojë masën e largimit të partnerit tuaj nga shtëpia ose banesa, të zbatojë masë ndalimi për hyrje të tij në një lagje të caktuar, si dhe masë ndalimi të kontaktimit për ju dhe fëmijët për 14 ditë. Brenda 8 ditëve, ju keni mundësinë të aplikoni për një zgjatje të njëhershme me tre muaj të këtyre [masave mbrojtëse](#). Qendrat për viktimat ju përkrahin dhe ju këshillojnë në lidhje me këtë kërkesë, falas dhe në besim. Këta 3 muaj janë zakonisht të mjaftueshëm për të zbatuar një ndarje gjyqësore. Nëse keni frikë se partneri juaj do t'ju kërcënojë edhe pas skadimit të masave mbrojtëse, ju mund t'i drejtoni një kërkesë gjykatës së qarkut për ndalim kontakti ose ndalim për hyrje në zonë (mbrojtje personale në përputhje me të drejtën civile ZGB 28 bj). Këtë kërkesë mund ta dorëzoni njëkohësisht me kërkesën për ndarje ligjore. Kërkoni informacione rreth kësaj mundësie nga një përfaqësim ligjor ose nga një qendër këshillimore. [Strehimoret e grave](#) ofrojnë mbrojtje gjithëpërfshirëse, nëse mendoni se partneri juaj nuk do t'i përmbahet masës së ndalimit të kontaktit.

Po nëse do të jetë e nevojshme që ndarja të bëhet shumë shpejt?

Ju mund të aplikoni për miratimin e masave superprovizore brenda procedurës së ndarjes ligjore. Për këtë, duhet të jeni në gjendje që të dëshmoni veprimet e dhunshme dhe urgjencën e kërkesës. Gjithashtu, duhet theksuar se çfarë dëmi i pariparueshëm do të shkaktohet nëse zgjidhja e kërkuar nuk urdhërohet menjëherë, pra pa dëgjuar palën kundërshtarë. Gjyqi, pastaj, do të rregullojë

përkohësisht – por shpejt – të njëjtat pika, të paktën pjesërisht, që rregullohen edhe në procedurën e ndarjes ligjore. Kërkesat që bëhen për marrjen e masave të përkohshme janë shumë të larta. Merrni këshilla ligjore për të mësuar rreth mundësive tuaja.


Kujt i takon banesa?

Personit që ka më shumë nevojë për të - zakonisht prindit që do të përkujdeset kryesisht për fëmijët, pas ndarjes. Shtroni kërkesat si në vijim, nëse doni të rrini edhe më tej në banesën familjare:

- Përcaktimin e afatit të largimit të partnerit tuaj (nga disa ditë deri në dy muaj). Nëse keni të dhëna se partneri juaj nuk do ta lëshojë vullnetarisht banesën, kërkoni autorizim nga zyra e kryetarit të bashkisë (Stadtammann-Amt) për ta përjashtuar personin.
- Kthimin e tufës së plotë të çelësave, që partneri juaj të mos ketë mundësi të hyjë në shtëpi pa lejen tuaj. Ndërroni bravat e banesës, nëse nuk jeni e sigurtë që i keni marrë të gjithë çelësat dhe ndiheni akoma e kërcënuar.

Te kush do të jetojnë fëmijët?

Te prindi, i cili ka qenë deri në atë moment më shumë përgjegjës për përkujdesjen personale të fëmijëve, por dhe që është në gjendje ta garantojë edhe më tej atë. Gjykata e kryen vetë vlerësimin, se ku ndihen fëmijët më mirë (mirëqenia e fëmijëve). Vëllëzërit dhe motrat zakonisht qëndrojnë së bashku. Fëmijët e moshës 6 vjeç e lart mund të dëgjojnë në gjyq, në kuadër të procedurës.



Sa shpesh do të përkujdeset prindi tjetër për fëmijët?

Si rregull, të dy prindërit kanë kujdestarinë dhe përgjegjësinë e përgjysmuar të kujdesit edhe pas ndarjes. Të dy prindërit kanë të drejtën e kontaktit personal me fëmijët e tyre. Ju mund të bëni një marrëveshje me prindin tjetër dhe ta miratoni atë nga gjykata. Bëni kujdes që të përcaktohen orare fikse të dorëzimit të fëmijëve dhe të keni një marrëveshje edhe për ditët e festave, si Pashkët, Rrëshajat dhe Krishtlindjet.

Nëse bashkëshorti juaj i ka kërcënuar ose rrahur edhe fëmijët, si dhe, nëse gjatë dorëzimit të fëmijëve ndodhin në mënyrë të përsëritur situata të dhunshme (që përkeqësohen), mund të kërkonti një të drejtë vizite me shoqërim ose një asistencë ligjore të së drejtës së vizitës. Një heqje e plotë e përgjegjësisë së kujdesit urdhërohet vetëm nëse fëmijët janë në rrezik të lartë dhe zakonisht vetëm për një periudhë të kufizuar kohore.

Nëse ju dhe bashkëshorti juaj nuk arrini një marrëveshje për kujdestarinë dhe kujdesin, gjykata do të marrë një vendim. Për këtë qëllim, gjykata mund të caktojë në mënyrë të pavarur një përfaqësues/e të fëmijëve ose ju mund të aplikoni vetë në gjykatë për një [avokat/e të fëmijëve](#). Avokatët/et e fëmijëve përfaqësojnë ekskluzivisht interesat e fëmijëve. Shpenzimet duhet të përballohen nga prindërit, por mund të mbulohen edhe prej ndihmës së procesit falas nëse keni të drejtë.



Termet e shënuar në tekst janë lidhur me faqet e internetit dhe dokumentet që mund të përdorni duke përdorur kodin QR.

Me se të jetojmë?

Mund të kalojnë javë apo muaj, derisa të paraqitet një akt-vendim për kontribute kompensuese për jetesë. Si masë paraprake, regjistrohuni në ndihmën sociale sapo të keni paraqitur kërkesën tuaj për ndarje ligjore. Nëse keni pak ose aspak të ardhura tuajat, ju keni të drejtë për mbështetje financiare nga shteti. Nëse keni një numër llogarie ose një kartë krediti të përbashkët me bashkëshortin tuaj, atëherë:

- Tërhiqni menjëherë, brenda mundësive, shumën e nevojshme të parave për tre muaj, nëse kontoja ose karta e kreditit janë të regjistruara në emrin e tij dhe nëse nuk keni para të mjaftueshme mënjatë.
- Bllokojeni menjëherë autorizimin e bashkëshortit mbi llogaritë ose kartat e kreditit, nëse ato janë të regjistruara në emrin tuaj.

Në kuadër të procedurës së ndarjes ligjore, llogaritet nevoja e të dyja ekonomive shtëpiake dhe kryhet tërheqja nga të ardhurat përkatesë të secilit. Nëse pas plotësimit të nevojave mbetet një tepëri, kjo përdoret së pari për të mbuluar nevojat e fëmijëve dhe së dyti për të mbuluar një deficit të bashkëshortësisë. Nëse shpenzimet tuaja nuk mund të mbulohen nga të ardhurat dhe kontributet për jetesë, ju keni të drejtë për ndihmë sociale. Në rast ndarjeje, mund të keni të drejtë për përfitimet ditore të papunësisë, edhe nëse nuk keni punuar së fundmi.

Kontributet për jetesë të fëmijëve, që janë përcaktuar në vendimin e ndarjes ligjore, mund të jepen paraprakisht nga shteti. Parapagimi bazohet në shumën maksimale të pensionit AHV/IV të fëmijës (në vitin 2023 kjo ishte 980 franga). Nuk ka paradhënie për mbështetje financiare të bashkëshortëve. Zyra përmbartimore e komunës suaj do të ndjekë ekzekutimin e detyrueshëm (Betreibung) të personit përgjegjës për mbajtje.

A ndikon ndarja mbi statusin tim të qëndrimit?

E drejta e qëndrimit në Zvicër shpesh lidhet me bashkëjetesën me bashkëshortin (statusi i qëndrimit B për bashkim familjar). Lidhur me këtë ekzistojnë dallime ndërmjet personave me shtetësi të Bashkimit Evropian (BE), të cilët përgjithësisht kanë kushte më të mira për qëndrim dhe vendndodhje në Zvicër, dhe personave nga vendet e treta. Për personat e vendeve të treta, në rastin e ndarjes, ekziston mundësia për zgjatjen e statusit të qëndrimit, nëse martesë dhe bashkëjetesa në Zvicër ka zgjatur së paku 3 vjet dhe ka pasur integrim të suksesshëm. Por ju mund të paraqisni edhe arsye të rëndësishme personale, veçanërisht nëse keni qenë viktimë e dhunës në familje, ose nëse riintegrimi social në vendin tuaj të origjinës duket të jetë në rrezik serioz. Mbani çdo [dëshmi të mundshme](#), si certifikata mjekësore, raporte nga strehimoret/ qendrat e këshillimit të grave ose urdhrat e policisë. Statusi i ligjshëm i qëndrimit nuk duhet të jetë arsye për të duruar dhunën në familje. Ne do t'ju këshillojmë për këtë çështje pa pagesë dhe në mënyrë konfidenciale.

Ç'ndodh në seancën gjyqësore të ndarjes ligjore?

Informohuni për procedurën e zhvillimit të një seance gjyqësore të ndarjes ligjore pranë një qendre këshillimore, një përfaqësimi ligjor ose në gjykatë. Nëse shkoni në gjykatë pa përfaqësim ligjor:

- mos nënshkruani asnjë marrëveshje, për të cilën jeni e pasigurtë ose
- nënshkruajeni, por këmbëngulni për kushtin e të drejtës së kundërshtimit brenda 10 ditëve. Brenda 10 ditëve, paraqiteni marrëveshjen në këshillim juridik për vlerësim dhe, nëse është e nevojshme, kundërshtojeni atë brenda afatit.

Nuk lejohet marrja e fëmijëve në seancën gjyqësore të ndarjes ligjore. Rezervoni një ditë të tërë për seancën dhe organizoni kujdestarinë e fëmijëve në mënyrë të tillë, që të mos u shkaktohet stres në rast se seanca zgjatet. Aplikoni në gjykatë me një kohën e duhur për një person përkthyes gjatë seancës dëgjimore, nëse gjermanishtja nuk është gjuha juaj amtare dhe nuk jeni e sigurtë se mund të kuptoni plotësisht dhe/ose të shpjegoni gjithçka në gjermanisht.

Ç'mund të ndërmarr kundrejt një vendimi gjyqësor?

Nëse nuk pajtoheni me vendimin gjyqësor të ndarjes ligjore, duhet ta kërkonti atë të arsyetuar me shkrim, brenda 10 ditësh, ose nëse keni marrë një vendim të arsyetuar, të bëni apelim brenda afatit të caktuar (shih informacionin mbi mjetet juridike në fund të aktgjykimit). Pasi të ketë skaduar kjo periudhë pa e përdorur të drejtën, vendimi gjyqësor bëhet i formës së prerë dhe ju mund të kërkonti një modifikim vetëm nëse situata ka ndryshuar ndjeshëm dhe përgjithmonë që nga gjykimi.

Po sikur të ktheheshim përsëri bashkë?

Nëse do të jetoni përsëri me bashkëshortin tuaj, vendimi do të shlyhet automatikisht pas rreth 4 javësh. Në rast të një ndarjeje të përsëritshme të mëvonshme, duhet të fillohet një procedurë tjetër për ndarjen ligjore, e cila nis nga e para.

Mos është shkurorëzimi i menjëhershëm një zgjidhje më e mirë?

Shkurorëzimi mund të kryhet në çdo çast, nëse të dyja palët pajtohen me këtë dhe e konfirmojnë para gjykatës së qarkut vullnetin e tyre për t'u

shkurorëzuar. Përvoja na mëson, që shpeshherë ndodh që ky konfirmim anulohet. Kështu që, hapja e procedurës së ndarjes, është rruga më e shpejtë për ta kthjelluar situatën përsa u përket kontributeve për jetesë, përcaktimit të banesës dhe përgjegjësisë të kujdesit për fëmijët. Një shkurorëzim kundër vullnetit të bashkëshortit lejohet vetëm pas skadimit të afatit 2-vjeçar të ndarjes. Në rastin kur vazhdimi i martesës është i papranueshëm, mund të ngrihet padi për shkurorëzim nga njëra palë. Megjithatë, pengesat janë shumë të larta dhe, nëse arsyet e shkurorëzimit kundërshtohen, procesi zgjat shumë, shpesh mbi 2 vjet, kështu që procedura e ndarjes sjell qartësi më shpejt. Mësoni më shumë nga një qendër këshillimore, këshillim ligjor ose gjykatë.

Ç'mund të bëj, nëse kam qenë e detyruar të martohem kundër vullnetit tim?

Zgjedhja e lirë e bashkëshortes/bashkëshortit është një e drejtë që vlen për të gjithë njerëzit që jetojnë në Zvicër. Ligji zviceran i ndalon martesat që janë lidhur me detyrim, pa marrë parasysh nëse janë lidhur jashtë vendit apo në Zvicër. Kontaktoni www.zwangsheirat.ch ose një qendër këshillimore për viktimat. Do të këshilloheni dhe do të shoqëroheni falas, në gjuhë të ndryshme.

Si duhet të veproj nëse dua ta zgjidh bashkëjetesën e regjistruar?

Çiftet me të njëjtën gjini që kanë regjistruar bashkëjetesën e tyre përpara datës 1 korrik 2022, mund ta iniciojnë ndarjen në gjykatë në vendbanimin e tyre. Nëse ju dhe partneri juaj nuk mund të bini dakord për zgjidhjen, periudha e përcaktuar e ndarjes për zgjidhjen e një bashkëjetese të regjistruar është 1 vit. Në gjykatë rregullohen të njëjtat pika si në procedurën e

ndarjes ligjore. Nëse përjetoni dhunë ose kërcënoheni nga partneri juaj, policia mund të marrë masa mbrojtëse në përputhje me [Ligjin e Mbrojtjes nga Dhuna](#) për t'ju mbrojtur.

Ne bashkëjetojmë pa lidhje ligjore (Konkubinat) dhe unë dua të ndahem

Bashkëjetesa nuk është formë jetese që ka lidhje ligjore të detyrueshme. Në rast të ndarjes, pikat e mëposhtme mund të jenë të rëndësishme:

- Në rast se ekzistojnë fëmijë të përbashkët, procedura për ndarjen e përgjegjësisë së kujdesit zhvillohet në "Autoritetin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rriturve" [KESB](#). Për më shumë informacion, mund të kontaktoni [shërbimin ligjor rajonal](#).
- Nëse nuk do të bini dakord në përcaktimin e kontributit për jetesën e fëmijëve, këtë do ta vendosë [gjykata e qarkut](#) në vendbanimin tuaj. Personi, i cili e merr përsipër kryesisht përkujdesjen e fëmijëve, pas zgjidhjes së bashkëjetesës, nuk ka të drejtë për kontribute për jetesë. Sapo gjykata të ketë juridiksion për të vlerësuar mbështetjen e fëmijëve, përgjegjësia për rregullimin e përgjegjësisë së kujdesit kalon nga KESB në gjykatë.
- Kush ka të drejtë të qëndrojë në banesë, varet nga kontrata e qirasë dhe nga bashkëpunimi i qiradhënësës/qiradhënësit dhe i ish-partnerit.

Meqenëse, në rastin e ndarjes së bashkëjetesës, situata ligjore është e ndërlikuar, është e dobishme marrja e këshillave në një qendër këshillimore ose në një përfaqësim ligjor. Nëse partneri ushtron dhunë ndaj jush apo ndaj fëmijëve, ose nëse ju kërcënon se do ta bëjë këtë, ju mund të përfitonit nga masat mbrojtëse, mbi bazën e [Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna](#).

Adresa të rëndësishme

Hapja e procedurës së ndarjes ligjore
[Gjykata e qarkut të vendbanimit tuaj](#)
[Formulari i procedurës për ndarjen ligjore](#)

Ndihmë mjekësore dhe certifikata
www.permanence.ch
Tel. 044 215 44 44

Avokatët/Shoqata e Avokatëve (Anwaltsverband):
www.zav.ch
www.anwaltskollektiv.ch
www.djs-jds.ch

Bashkëjetesa dhe fëmijët
www.zh.ch
Mbështetje financiare dhe kujdesi prindëror

Mbrojtje
Numri i urgjencës së policisë 117
Strehimoret e grave:
www.frauenhaeuser.ch

Sigurimi i provave
www.with-you.ch

Këshillimoret e Asistencës së Viktimave
www.bif-frauenberatung.ch
www.frauennottelefon.ch
www.frauenberatung.ch

Përkrahje për fëmijët
www.kokon-zh.ch
www.okeywinterthur.ch
www.kinderanwaltschaft.ch



BIF Beratungsstelle für Frauen
gegen Gewalt in Ehe und Partnerschaft

Postfach, 8031 Zürich
Tel. 044 278 99 99
www.bif-frauenberatung.ch
info@bif.ch

PC 87-137016-4
IBAN: CH32 0900 0000 8713 7016 4



* Për shkak të lexueshmërisë më të mirë, ne kemi përdorur vetëm formën mashkullore për partnerët. Me këtë, nënkuptohen të gjithë personat, pavarësisht identitetit të tyre gjinor.

